



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e pranimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Flori Rexhepi	23.03.2026	02.04.2026	2026/0161

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 17.03.2026, OE “Dauti Komerc SH.P.K.”- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2026/0161, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE “Beni Dona Plast SH.P.K.”- Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Furnizim me artikuj ushqimor - Lot 3 dhe Lot 5” me nr. të prokurimit: "201/26300-25-11214-1-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Agjencia Qendrore e Prokurimit .

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: **Totali: 2,010,000.00€**

Lot 1 – Lot 3 - Furnizim me qumësht dhe produkte të qumështit: 670,000.00€

Lot 2 – Lot 5 - Furnizim me artikuj të ndryshëm ushqimor : 1,340,000.00€

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

--

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Shkeljet e LPP-se nga ana e AK-së:

Neni 1 – Qëllimi

Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

Neni 7 – Barazia në trajtim/ jo-diskriminimi

Neni 52 - Njoftimi i kriterëve për dhënien e kontratës

Neni 59 – Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave

Neni 60 – Kriteret e dhënies

Rregullorja nr. 001/2022, për Prokurim Publik

Neni 40 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve

KRITERET PËR VLERËSIM

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1	Kërkesa 1: Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses furnizim me produkte të ngjashme në 3 (tri) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit të këtij njoftimi për kontratë) minimum: Lot 1: 1,000,000.00€ Lot 2: 2,000,000.00€ Kërkesa 2: Deklaratën për specifikacionet teknike për mallrat e ofruara duke deklaruar që mallrat e ofruar nga ju janë sipas Aneksin 1 të dosjes së tenderit dhe Përshkrimit të artikullit tek Lista e Çmimeve.
	9.2	Dokumentet dëshmuuese për mundësitë teknike dhe/ose profesionale Evidenca 1: Operatori Ekonomik duhet të plotësoj formularin standard të dhënë në Aneksin 8 të Dosjes së Tenderit apo ndonjë format tjetër që përfshinë afërsisht të dhënat e aneksit 8 dhe të bashkëngjis certifikatat përkatëse ose ndonjë dokument tjetër që evidenton liferimin e tillë, gjithashtu Operatori Ekonomik për plotësimin e kësaj kërkesë mund të bashkëngjis edhe fatura të shitjes (ku duhet të shihet qarte të paktën: blerësi, data, artikujt dhe shuma.) apo edhe duke paraqitur referenca si nga blerësi publik apo nga blerësi privat. Evidenca 2: Deklaratën e nënshkruar për specifikacionet teknike për mallrat e ofruara duke deklaruar që mallrat e ofruar nga ju janë sipas Aneksin 1 të dosjes së tenderit dhe Përshkrimit të artikullit tek Lista e Çmimeve.

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit të datës 06.03.2026, komisioni vlerësues ka konstatuar si në vijim:

OE ankues është i përgjegjshëm.

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE **“Dauti Komerc SH.P.K.”**, lidhur me aktivitetin e prokurimit **“Furnizim me artikuj ushqimor - Lot 3 dhe Lot 5”** me numër të prokurimit: **“201/26300-25-11214-1-1-1**, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Agjencia Qendrore e Prokurimit**

OE i rekomanduar për kontratë është i përgjegjshëm.

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “Dauti Komerc SH.P.K.”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me artikuj ushqimor - Lot 3 dhe Lot 5” me numër të prokurimit: “201/26300-25-11214-1-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Agjencia Qendrore e Prokurimit



Republika e Kosovës
 Republika Kosova - Republic of Kosovo
 Qeveria – Vlada - Government
 Ministria e Financave – Ministarstvo za Finansije – Ministry of Finance
AGJENCIA QENDRORE E PROKURIMIT
 CENTRALNA AGENCIA NABAVKE / CENTRAL PROCUREMENT AGENCY
NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES

Sipas Nenit 43.7 dhe 44.2 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ të Prokurimit Publik

Titulli i kontratës i dhënë nga autoriteti kontraktues: **Furnizim me artikuj ushqimor - Lot 3 dhe Lot 5;**
 Numri i prokurimit: **201/26300-25-11214-1-1-1**

Nr.	Emri dhe adresa e Operatorit Ekonomik	LOT 1	LOT 2
		VLERA NË EURO	VLERA NË EURO
1.	Beni Dona Plast SH.P.K. Ulpiana Tregu i Gjellbërt, PRISHTINË 810545981	548,925.00	1,189,675.00
2.	Grup i Operatorëve Ekonomik HC STORE SH.P.K.; MEKA SH.P.K.; Fehmi Cakiqi B.I. Rr. Ilaz Kodra Nr. 55, Drenas	589,975.00	1,179,875.00
3.	N.T.P "HAJDINI COMERC " ASHANAJKA P.N., GLLOGOC 600055322	614,620.00	1,219,325.00
4.	Dauti Komerc SH.P.K. Gërllicë, Ferizaj 810655524	568,750.00	1,248,330.00

Rezultati i aktivitetit të prokurimit:

Agjencia Qendrore e Prokurimit shpërblen me kontrata:

Për Pjesën (LOT) 1 – Lot 3 - Furnizim me qumësht dhe produkte të qumështit, Operatori Ekonomik Beni Dona Plast SH.P.K. Ulpiana Tregu i Gjellbërt, PRISHTINË, në vlerën prej 548,925.00€.

Për Pjesën (LOT) 2 – Lot 5 - Furnizim me artikuj të ndryshëm ushqimor, Operatori Ekonomik Beni Dona Plast SH.P.K. Ulpiana Tregu i Gjellbërt, PRISHTINË, në vlerën prej 1,189,675.00€.

ZPP: *Emine Masurica*
 Data: 27.02.2026
 Prishtinë / g

INFORMACIONET SHITESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

N/A

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **Dauti Komerc SH.P.K.**

Eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues i pakënaqur me Njoftimin mbi Vendimin (B58) të AK – **Agjencia Qendrore e Prokurimit**, ka parashtruar ankese ne OSHP me pretendimin se autoriteti kontraktues nuk i ka respektuar dispozitat e Nenit 59 të LPP-se, duke rekomanduar për kontrate OE të përgjegjshem.

Pretendimi nr. 1

OE ankues, pretendon se OE i rekomanduar për kontrate nuk e ka plotësuar kërkesën nr. 2 te kapacitetit mbi gjendjen ekonomike dhe financiare, ku AK ka kërkuar:

Kërkesa 2:Operatori ekonomik duhet të dëshmoj se ka kapital financiar për realizimin e kontratës: mjete të gatshme në bankë **ose** mbështetje bankare qasje te pakushtëzuar në kredi për realizimin e kontratës **ose** bilanc pozitive tek Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fund të vitit ne Pasqyra e rrjedhjes së parasë për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2025 - në vlerë prej së paku:

Lot 1 – 100,000.00€;

Lot 2 – 200,000.00€.

Eksperti shqyrtues, pas ekzaminimit të shkresave të lendes, konkretisht ofertën e OE të rekomanduar për kontrate lidhur me dëshmitë për kërkesën e cituar si me larte, vlerëson se i rekomanduari për kontrate e ka plotësuar kërkesën nr. 2 te kapaciteti ekonomik dhe financiar,

konkretisht në dëshminë e dorëzuar në ofertën e OE të rekomanduar për kontratë shihet se ka mjete mbi 300,000.00€ dhe për shkak se i njëjti ka dorëzuar në ofertën e tij kërkesën për sekret afarist, eksperti shqyrtues nuk mund të jap me shumë informacione, mirëpo dëshmia për panelin shqyrtues gjenden në platformën e E-Prokurimit. Andaj pretendimi i OE ankues është i pa bazuar.

Pretendimi nr. 2

OE ankues pretendon se AK nuk i ka ofruar qasje të plote, për shkak të kërkesës për sekret afarist të cilën OE të rekomanduar për kontratë e ka dorëzuar në ofertën e tij.

Eksperti shqyrtues, sqaron se OE i rekomanduar për kontratë e ka dorëzuar kërkesën për sekret afarist dhe njëherit sqaron se OE ankues nuk ka pretendim tjetër lidhur me ofertën e të rekomanduarit për kontratë.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK.

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “**Dauti Komerc SH.P.K.**”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “**Furnizim me artikuj ushqimor - Lot 3 dhe Lot 5**” me numër të prokurimit: “**201/26300-25-11214-1-1-1**”, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Agjencia Qendrore e Prokurimit**

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **Agjencia Qendrore e Prokurimit**
- Panelit Shqyrtues – **OSHP**
- OE ankues – **Dauti Komerc SH.P.K.**

Florije Rexhepi

